

KONTRATE

SHIT - BLERJE TE AKSIONEVE

Sot, më datë 08/05/2025 (dymije e njezete e peste), sa me poshte u paraqiten palet:

Shoqëria "ALBSEA TRANSPORT" sh.p.k, person juridik shqiptar me seli: Lagjja nr. 3, Objekt me nr. pasurie 3/375+1-1, Hyrja 1, Apartamenti 1, Durres, me NUIS K31714513G, përfaqësuar nga administratori Z. Froid Jasimi, banues ne Durres, i dtl. 04.10.1999, identifikuar me ID nr. Personal J91004087O me nr. 032957605 (*referuar si "SHITESI I AKSIONEVE"*)

Shoqëria "A.I.B.A KOMPANI" SH.A, person juridik shqiptar me seli në L.14. Shkozet, Durrës, Rr "Tirana", me NUIS J61818528J, përfaqësuar nga administratori zj Enka Rushani, banuese ne Shijak, e dtl. 02.04.1984, identifikuar me ID nr. I45402006A, (*referuar si "BLERESI I AKSIONEVE"*)

Kjo kontratë shitblerje eshte lidhur duke patur parasysh vullnetin e lire dhe te plote te palëve për transferimin e aksioneve qe pala shitesë zoteron ne shoqërine tregtare DIGIT-ALB Sh.a.

Sa më sipër, palët ranë dakort për hartimin dhe nënshkrimin e kontratës me termat si më poshtë vijon :

1. Shitesi gezon te drejten e plote dhe ekskluzive te pronesisë dhe zoterimit te 24205.3900 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 10.52% (dhjete pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, e themeluar dhe organizuar ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me NUIS K41719004D.
2. Shitesit transferon nepermjet shitjes dhe dorezon pronesine e plote te aksioneve te cilesuar ketu me sipër, konkretisht te 24205.3900 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 10.52% (dhjete pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, dhe te gjitha te drejtat qe ai gezon si aksionar, ja transferon/kalon blesesit, i cili pranon ti bleje kundrejt cmimit ne vleren prej 1,252,000 (*nje milion e dyqind e pesedhjete e dy mije*) Euro.

Pagesa e cmimit te shitjes do te behet me 5 (pese) keste ne kete menyre:

- Kesti pare ne vleren prej 250,400 (*dyqind e pesedhjet mije e katerqind*) Euro do te paguhet nga blesesi deri me date 31.07.2025;
- Kesti dyte ne vleren prej 250,400 (*dyqind e pesedhjetmije e katerqind*) Euro do te paguhet nga blesesi deri me date 31.10.2025;
- Kesti trete ne vleren prej 250,400 (*dyqind e pesedhjet mije e katerqind*) Euro do te paguhet nga blesesi deri me date 31.12.2025;
- Kesti katert ne vleren prej 250,400 (*dyqind e pesedhjet mije e katerqind*) Euro do te paguhet nga blesesi deri me date 31.03.2026.

- Kesti peste ne vleren prej 250,400 (dyqind e pesedhjetmije e katerqind) Euro do te paguhet nga bleresi deri me date 31.05.2026.
3. Bleresi do te paguaje cmimin e shitjes sipas pikes 2 (dy)me lart, ne llogarine bankare te shitesit, e cila do ti komunikohet me shkrim pales blerese, konkretisht:
 - Emri Bankes.Pro Credit Bank
 - Titullari i llogarise:A.I.B.A Kompani
 - IBAN.AL66209122400000212418910102
 - Kodi Swift:FEFAALTR
 4. Shitesi ne kete menyre deklarone qe aksionet e transferuara ne baze te kesaj kontrate jane te lira nga cdo peng, barre siguruese, kufizim, garanci e nje tjeter natyre, sipas verifikimit dhe ekstraktit tregtar ne QKB.
 5. NËPËRMJET realizimit të këtij veprimi juridik, bleresi do të fitojë cilësinë e aksionerit ne masen prej 24205.3900 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 10.52% (dhjete pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise DIGIT-ALB sh.a, ne daten e nenshkrimit te kontrates.
 6. Shitesi pas transferimit te mases totale te aksioneve tek bleresi, do te humbasi cilesine e aksionarit ne shoqeri, duke humbur te drejten e pronesis se mases se aksioneve te citura me lart, respektivisht me date 08.05.2025.
 7. Pas transferimit te aksioneve, bleresi merr persiper personalisht apo nga ndonje person i autorizuar prej tij apo nga administratori i shoqerise "Digit Alb" sh.a, te paraqitet dhe te regjistroje kete kontrate prane Qendres Kombetare te Biznesit si dhe Qendres se Regjistrimit te Aksioneve per te kryer veprimet e nevojshme te transferimit/kalimit te aksioneve ne favor te bleresit ne masen e cituar me lart.
 8. Kjo Kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit te saj nga palet respektive.
 9. Kjo Kontratë mund të ndryshohet vetëm sipas marrëveshjes së shkruar të përfunduar midis Palëve.
 10. Nese bleresi nuk paguan sikur 1 (nje) kest brenda afatit te percaktuar me lart, shitesit i lind e drejat te kerkoje ti kthehet masa prej 24205.3900 numer aksione te zakonshme te cilat perfaqesojne 10.52% (dhjete pike pesedhjete e dy perqind) te kapitalit aksionar te shoqerise DIGIT-ALB sh.a. Kthimi i aksioneve do te realizohet nepermjet aplikimit prane QKB-se te nje Deklarate noteriale te leshuar nga pala shitese me pershkrim "kthimin e aksioneve ne masen e transferuar sipas parashikimeve te Kontrates se shitblerjes se aksioneve", pa qene e nevojshme provueshmeria e mospageses saj. Ne kete rast cdo pagese e kryer deri ne ate moment si cmim i kesaj kontrate do ti kthehet pales blerese dhe kthimi i aksioneve nuk do te aplikohet pa u shoqeruar me transferten bankare te provueshmerise se kthimit te vleres se paguar ne favor te pales blerese.

11. Cdo mosmarreveshje qe mund te lindin ne lidhje me ekzekutimin dhe interpretimin e kesaj kontrate, palet do te ofrohen ta zgjidhin midis tyre, ne te kundert Gjykata e Rrethit Gjyqesor Durres, do te jete kompetente per zgjidhejn e saj.
12. Kjo Kontratë është e përbërë nga 3 (tre) flete, dhe është përgatitur në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

PALËT

BLERESI

Shoqeria "A.I.B.A KOMPANI" sh.a
Administratori
Zj. Enka Rushani

Enka Rushani



SHITESI

Shoqeria "ALBSEA TRANSPORT" sh.p.k
Administratori
Z. Froid Jasimi

Froid Jasimi



Froid Jasimi